



UNIVERSITETI POLITEKNIK
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit
Sheshi “Nënë Tereza”, Nr 1, Tiranë

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË
KANDIDATËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE
NË
*INXHINIERI TELEKOMUNIKACIONI***

Tiranë, Janar 2017



I. Të përgjithshme

Neni 1

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni është hapur bazuar në propozimin e Senatit të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe VKM Nr. 768, datë 16.11.2006 “Për hapjen e ciklit të dytë të studimeve Master, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, të Universitetit Politeknik të Tiranës”.

Neni 2

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, duke u dhënë mundësi të diplomuarve:

- të fitojnë njohuri të thella në aspektet metodologjike dhe aplikative të matematikës dhe shkencave të tjera bazë të Inxhinierisë së Telekomunikacionit dhe të jenë në gjendje të përdorin këto njohuri për të interpretuar problemet e Inxhinierisë së Telekomunikacionit.
- të njohin në përgjithësi dhe në thellësi fushat e inxhinierisë së Telekomunikacionit në të cilat të jenë gjendje të identifikojnë, formulojnë dhe zgjidhin problemet duke përdorur metoda, teknika dhe paisje bashkëkohore.
- të formojnë aftësitë e nevojshme për të punuar në projektim, vënie në jetë dhe mirëmbajtje të sistemeve elektronike, menaxhim të teknologjive të komunikimit dhe të protokolleve të transmetimit të të dhënave.
- të fitojnë aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara.
- të jenë të aftë të kryejnë eksperimente dhe të analizojnë dhe interpretojnë të dhënat e marra prej tyre.
- të fitojnë aftësi në përdorimin e mjeteve dhe metodologjive në mënyrë që të bëjnë të mundur trajtimin e proceseve industriale dhe planifikimin e zgjidhjeve në sferën e sistemeve realë.
- të njohin përgjegjësitë e veta profesionale dhe etike.
- të fitojnë aftësi për organizimin, administrimin dhe aspektet ekonomike të ndërmarjeve.
- të fitojnë aftësi vendimmarrëse dhe komunikimi.
- të kenë mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë (studimet doktorate) në inxhinieri telekomunikacioni apo në fusha të afërta me të.
- të venë në provë njohuritë e grumbulluara dhe aftësitë inxhinierike dhe të komunikimit në fusha tipike si, rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i thellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje/organizata publike apo private.

Neni 3

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni është një program studimi i ciklit të dytë i hapur pranë Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, UPT.



UNIVERSITETI POLITEKNIK
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit
Sheshi “Nënë Tereza”, Nr 1, Tiranë

Neni 4

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

II. Organizimi

Neni 5

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT dhe drejtohet nga Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit si njësi bazë e këtij fakulteti.

Neni 6

Detyrat e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit janë:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në Senatin e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështetëse për mbarëvajtjen e programit të studimit

Neni 7

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni organizohet pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në korpusin universitar Sheshi “Nënë Tereza”, si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

Neni 8

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

III. Pranimi i kandidatëve

Neni 9

Në Programin e Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë:

- I. Diplomë të nivelit të parë Bachelor (ose ekuivalente me të sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Inxhinieri Telekomunikacioni, Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Informatike të fituar pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT, ose diploma të ngjajshme të fituara në UPT ose jashtë saj. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisioni ad-hoc që ngrihet nga departamenti. Kandidatët fitues përcaktohen nga komisioni ad-hoc i ngritur nga departamenti bazuar në kuotat e pranimit të miratuara nga MASH, parimit të meritës dhe preferencës së kandidatit si dhe prioriteteve të



UNIVERSITETI POLITEKNIK
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit
Sheshi “Nënë Tereza”, Nr 1, Tiranë

vendosura nga departamenti. Lista e fituesve shpallet në ambjentet e FTI dhe faqen elektronike të FTI;

- II. Njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.

Pranimet bëhen sipas hapave më poshtë:

1. Rregjistrohen fillimisht, të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor, studentët që kanë diplomë Bachelor në Inxhinieri Telekomunikacioni ose Inxhinieri Elektronike, të fituar pranë DET-FTI, UPT. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jete më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët.
2. Në rast se, pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët që kanë diplome Bachelor në Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Telekomunikacioni, të fituar pranë FTI, UPT, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike. Nota mesatare e ponderuar e diplomës Bachelor për kandidatët fitues, të kësaj kategorie, *preferohet* të jetë më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00). Në rast të kuotave të lira, nuk do përjashtohen aplikantët (*vetëm për këtë kategori studentesh/aplikantësh*) me mesatare më të ulët;
3. Në rast se, edhe pas plotësimit të pikës 2, të nenit 9, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim studentët sipas diplomës Bachelor (ekuivalente me programet e studimit në Inxhinieri Telekomunikacioni) të fituar në UPT ose jashtë saj, sipas mesatares së ponderuar të diplomës Bachelor më e madhe ose baraz me shtatë (≥ 7.00).

Neni 10

Tarifa e rregjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FTI dhe UPT. Kandidatët rregjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FTI.

Neni 11

Rregjistrimet në Programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e MAS. Ato kryhen pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 12

Njohja e krediteve bazohet në rregulloren e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Neni 13

Në programin e studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptare ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave



UNIVERSITETI POLITEKNIK
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit
Sheshi “Nënë Tereza”, Nr 1, Tiranë

të përcaktuara në statutin e UPT, rregulloren mësimore të UPT dhe rregulloren e brendshme të FTI dhe rregulloren e programit të studimit.

IV. Zhvillimi i aktiviteteve

Neni 14

Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni zhvillohet me kohë të plotë. Ai zgjat dy vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe zhvillohen lëndët sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të dytë zhvillohet mbrojtja e diplomës. Diploma është një punim i pavarur shkencor i studentit të programit të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni.

Neni 15

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni është gjuha shqipe.

Neni 16

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekani i FTI.

Neni 17

Kontrolli i dijeve në çdo modul/lëndë bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesmarrjes në laborator dhe provës përfundimtare, provimit.

Neni 18

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UPT-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FTI-së.

Neni 19

Rezultatet e frekuentimit, provave përfundimare të moduleve dhe të mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

Neni 20

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë *”Master i Shkencave në Inxhinieri Telekomunikacioni”* të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe nga Rektori i UPT-së.

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Asoc. Algenti Lala